



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Deklaratë e Përbashkët për Forcimin e Procesit Zgjedhor në Kosovë

Ne, Kryetarët e Grupeve Parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, shprehim gatishmërinë dhe zotimin për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, duke adresuar fillimisht çështjet e rekomanduara nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së, të nxjerra që nga viti 2013, në veçanti në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të vitit 2017.

Përmirësimi dhe forcimi i procesit zgjedhor është nevojë e çdo demokracie, në veçanti e demokracive në zhvillim. Ky proces duhet të bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e zgjedhjeve të mëparshme, dhe synon të krijojë një ambient për zgjedhje të lira, të drejta dhe transparente, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira.

Kjo nismë synon të adresojë rekomandimet e nxjerra nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së dhe të përmirësojë më tej praktikrat e mira zgjedhore përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent.

Angazhimi i forcave politike për përmirësimin e procesit zgjedhor nuk lidhet në asnjë formë me zgjedhjet e parakohshme apo të jashtëzakonshme që mund të ndodhin në ndërkohë.








Prandaj, dakordohemi që:

- Kuvendi i Kosovës, në pajtim me Rregulloren e Punës, të **krijojë Komision Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, në të cilin marrin pjesë Kryetarët e Grupeve Parlamentare. Grupet e mëdha parlamentare, të cilëve ju takojnë nga dy anëtarë duhet, për aq sa është e mundur, të marrin parasysh aspektin e përfaqësimit gjinor.
- Në kuadër të **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, të krijohet **Grupi Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, ku përfaqësohen akterët e zgjedhjeve (shoqëria civile, media, institucionet relevante dhe ato që menaxhojnë zgjedhjet, si dhe akterët ndërkombëtarë), i cili grup ofron këshilla profesionale që lidhen me forcimin e procesit zgjedhor për qëllime të vendimmartjes nga ana e **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**.
- Kuvendi i Kosovës të ofrojë mbështetjen e nevojshme financiare dhe teknike/logjistike për **Komisionin Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**, si dhe për **Grupin Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor**.

Kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit të iniciojë procedurën për themelimin e **Komisionit Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Deklarate.

Ftojme BE-në dhe OSBE-në që të mbështesin dhe ndihmojnë **Komisionin Parlamentar ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** dhe **Grupin Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor** me ekspertizë dhe projekte për të mundësuar arritjen e objektivave të parapara.

Nënshkruar në Prishtinë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 11 prill 2019.

Grupi Parlamentar	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
LDK	Ardullaj Hoti	
PDK	Memli Krasniqi	
^{Levizja} VETËVENDOSJE!	Glauk Krasniqi	
PSD	Dardan SEJDIU	
AAK	Abdullah Jusufi	
NISMA Socialdemokratike	Bujar Shkëmbi	
SRPSKA LISTA	Sasa Milosavicevic	
GP-G+	Albert Zedaj	